



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më
29.06.2022, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Arianit Beqiri (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arbër Vokri (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Rashit Gashi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitija (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Berna Saraçi (LVV), Rita Zeqiri (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Liridon Selmani, (PDK), Granit Geci (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Endrit Zabërgja, (NISMA) dhe Agim Kuleta (LB).

Munguan: Berat Lahu (LVV), Trieria Kasumi-Berisha (LVV) dhe Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar i Komunës, Donjeta Sahatçiu, nënkryetare e Komunës, Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Florim Krasniqi, përfaqësues nga Drejtoria e Urbanizmit, Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Besianë Musmurati, drejtore e Drejtorisë së Arsimit, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fehmi Kupina**, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimin e pikave të rendit të ditës, kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Faqe Inga23

Amir Simnica propozoi që në rend të ditës të futet edhe pika "Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e një memoriali dhe çezmës së muhaxhirëve në Lagjen e Muhaxhirëve.

Lidhur me këtë propozim theksoi se, sot muhaxhirët jetojnë kudo në trojet shqiptare, një pjesë e tyre jetojnë në Prishtinë, ku janë edhe themelues të Lagjes së Muhaxhirëve dhe iu kemi borxh t'i nderojmë me një memorial.

Endrit Zabërgja ngriti shqetësim rreth pikave të rendit të ditës, duke cekur se pikat të cilat po propozohen për rend të ditës, nuk janë konform Planit të punës së Kuvendit, dhe kërkoi të dijë pse votohet Plani i punës në fillim. Ai propozoi që për mbledhjen e radhës, si pikë në rend të ditës të jetë edhe "Informata mbi gjendjen e rinisë së Prishtinës".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 45 vota për, u miratua propozimi i z. Simnica, që "Propozimvendimi për ndërtimin e një memoriali dhe çezmës së muhaxhirëve në Lagjen e Muhaxhirëve, hynë në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të katërt të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës;
2. Informatë mbi qarkoren buxhetore 2023/01;
3. Korniza afatmesme buxhetore 2023-2025 (KAB);
4. Propozimvendimi për transformimin e mjeteve nga fondi i rezervës komunale;
5. Propozimvendimi për caktimin e Komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo - arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës;
6. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Projektregulloren për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksë;
7. Informatë lidhur me mbjelljet pranverore në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës;
8. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollorë në lagjen "Kolovicë e Re" në Prishtinë;
9. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollorë në lagjen "Mati 1" në Prishtinë;
10. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollorë në lagjen "Kolovicë e Vjetër" në Prishtinë;
11. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu "KOST", SHA;
12. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e një memoriali dhe çezmës së muhaxhirëve në Lagjen e Muhaxhirëve;
13. Pyetje dhe përgjigje;
14. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të katërt të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës.

Gëzim Sveçla tha se përderisa nuk po i marrim me kohë procesverbalet, ne nuk po mundemi me i lexuar se çka kemi thënë në seancën e kaluar, edhe nuk është hera e parë që po ndodh kjo, është problem që po përsëritet. A mundeni me i dhënë zgjidhje kësaj çështjeje.

Fiknete Bejta shfaqti të njëjtin shqetësim për transkriptin dhe procesverbalin e mbledhjeve. Ajo tha se po ndihemi keq, sepse këto dokumente janë zyrtare dhe fjalitë, fjalët, gjuha që po përdoret në njëfarë mënyre neve po na i deformojnë ato fjalë çka po i themi, andaj të jetë një kujdes ma i shtuar në këtë aspekt.

Bahri Gashi tha se pjesa e administratës që merret me këtë punë, që po e bëjnë një punë të mrekullueshme, janë pak punonjës, për atë nuk kanë arritur ta bëjnë transkriptin dhe ekstraktin me kohë. Do të ishte mirë me e rritu pak stafin e atij shërbimi, se me të vërtetë kanë shumë punë dhe tepër janë të ngarkuar, e normal që edhe kanë me gabuar ndonjëherë.

Osman Bllaca tha se procesverbalet hartohen prej shërbimit të Kuvendit, mirëpo është shumë vështirë me e hartuar një procesverbal, për arsye se po krijohet shumë zhurmë në Kuvend edhe nuk po dëgjohet mirë të folurit e anëtarit, kështu që të folurit në disa raste edhe pa mikrofon, pastaj po krijohet një amulli edhe normal që rrjedhin ato gabime.

Sami Boroci theksoi se ndoshta kishte qenë mirë me e parë mundësinë me e zgjidhur çështjen e incizimit të mbledhjeve, pra më qenë edhe më e avancuar, sepse ka shumë qytetarë që i përcjellin këto seanca dhe mendoj se kjo e rrit transparencën dhe komunikimin me qytetarë.

Sa i përket kësaj formës së shkruar, e di që bëhet një punë e mirë, ka raste kur ne përdorim ndoshta shprehje që nuk e dëgjojmë veten, por në fund video vjen ashtu dhe hartuesit po i transmetojnë ashtu në procesverbal, dhe unë nuk po e shoh ndonjë farë problemi.

Me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna, kryesuesi konstatoi se më 32 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, u miratuan ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të katërt të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës.

Pika e dytë

Informatë mbi qarkoren buxhetore 2023/01.

Lidhur me Informatën mbi qarkoren buxhetore, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtore.

Gëzim Sveçla tha se, pasi që është informatë, nuk kemi me shtuar diçka në këtë drejtim, presim informacione tjera.

Donjeta Dragusha tha se është mirë që kjo qarkore është sjellë në Kuvend, pra është shumë e rëndësishme për përgatitjen e buxhetit për vitin pasues dhe vlerësimet për dy vitet e ardhshme. Ndërsa sa i përket kërkesave të qarkores buxhetore, kjo qarkore e specifikon

Faqe3nga23

disa herë zbatimin e Udhëzimit administrativ për definimin e projekteve kapitale dhe për klasifikimin e shpenzimeve, sepse në vitet e kaluara ndër shumë vërejtje tjera që ka pasur Komuna e Prishtinës nga Zyra Kombëtare e Auditimit, ka marrë edhe vërejtje për keq klasifikimin e shpenzimeve. Andaj është shumë e rëndësishme se edhe kërkesat që rrjedhin nga qarkorja, duhet të kemi shumë kujdes gjatë hartimit, e më pastaj edhe realizimit të buxhetit në këtë aspekt.

Leutrim Retkoceri theksoi se është e rëndësishme që kjo qarkore, për dallim prej vitit të kaluara, ka ardhur me kohë. Është pak shqetësuese për këtë qarkore, sepse tavanet që janë të planifikuara nga Ministria e Financave, për mendimin tim janë tavane të ulëta të parashikimit të të hyrave dhe të buxhetit të Komunës së Prishtinës. Një shqetësim tjetër që shihet edhe te granti specifik për arsim, granti bazë që është për vitin 2023 – 2025, nuk ka lëvizje të numrave, do të thotë nga 3086 mësimdhënës apo personel në këtë kategori, në Ligjin për buxhetin e vitit 2022 ka më pak e nuk pritet ndonjë rritje e konsiderueshme, mendoj se përbënë problem serioz për vitet e ardhshme. Po ashtu, janë edhe disa rrethana tjera vështirësuese që ndikojnë në buxhet dhe në çështjet tjera financiare të Komunës.

Valbona Ajeti tha se edhe ne si grup parlamentar këtë informatë e kemi analizuar dhe e mbështes parafolësin aty tek mësimdhënësit, por e mirëpresim deri në rishikimin e radhës.

Fiknete Bejta tha se Korniza afatmesme buxhetore komunale, paraqet një proces si mjet për zhvillimin e buxhetit në hartim, koordinim me Qeverinë dhe Komunën. Në këtë kornizë shihet se ka një diskrepancë të madhe në mes të atyre që paraqet Qeveria përmes realizimit në buxhet dhe objektivave që i ka paraparë Komuna, gjithsesi edhe Qeveria. Një prej objektivave të Komunës është edhe përfshirja e tërësishme e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, si dhe ngritja e nivelit të arsimit, që nënkupton gjithë përfshirja. Ne po synojmë të ndërtojmë sa më shumë çerdhe dhe shkolla, mirëpo rrezikohet që këto institucione të mbesin pa kuadro profesionale, sepse buxheti e limiton, buxheti i shtetit ka paraparë që të kemi kufizime buxhetore për mundësinë e punësimit të personelit arsimor. Gjithsesi i njëjti problem është edhe tek shëndetësia, tek kultura, rinia dhe sporti, edhe pse edhe objektivat e Komunës dhe të Qeverisë janë të ngjashme, mirëpo nuk janë të ngjashme në perspektivat buxhetore.

Prandaj kjo Kornizë afatmesme edhe pse nuk ka pasur edhe vitet e kaluara rishikim të buxhetit, mendoj se nuk do të ketë as këtë vit, dhe ne duhet të pajtohemi me këtë Kornizë afatmesme buxhetore, që mendoj se nuk përkon me objektivat e Kuvendit dhe Komunës së Prishtinës.

Lidhur me çështjet e ngritura nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha Valbona Makolli, drejtoreshë.

U konstatua se u përkrah Informata mbi qarkoren buxhetore 2023/01.

Pika e tretë

Korniza afatmesme buxhetore 2023 – 2025 (KAB)

Lidhur me Kornizën afatmesme buxhetore 2023 – 2025 (KAB), të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtore.

Feim Osmani tha se Korniza afatmesme buxhetore si dokument strategjik për Prishtinën, nuk është bërë konform nevojave dhe trendit të zhvillimit të përgjithshëm shoqëror e as në përputhje me mundësitë buxhetore që ka tani me kryeqytetin.

Duke i analizuar një nga një pozicionet buxhetore, të hyrat, grantet e po ashtu edhe shpenzimet, vërehet lehtësi se është bërë shpejt e shpejt, pa kujdes, edhe duke provuar për ti përafuar parashikimet shumë më shumë sesa që është e pranueshme dhe e nevojshme. Nëse i analizojmë për të gjitha drejtoritë veç e veç mundemi shumë lehtë ti dallojmë të metat e tij duke pasur para sysh se ky dokument është shumë i rëndësishëm, dhe duhet të miratohet pa gabime pastaj të shfrytëzohet.

Afër 335 milionë buxhet i paraparë për tri vjet, meritojnë vëmendje shumë më të madhe dhe planifikim shumë më ambicioz.

Ne e kemi parasysh se planifikimi mund të ndryshojë edhe gjatë procesit të hartimit të buxheteve vjetore, mirëpo kjo nuk do të thotë se kjo kornizë nuk duhet të ishte shumë më shumë përmbajtësore.

Sa i përket të hyrave vetanake, tabelat e të hyrave buxhetore komunale për periudhën 2023- 2025, do duhej të shprehte më shumë kualitetin që i sjell kryeqytetit sesa shifrat e përkthyer në para. Po ashtu, sa i përket investimeve kapitale natyrisht, por për të gjitha drejtoritë veç e veç, diku ka mjete të parapara më shumë sesa që përkojnë me projektin, diku ka shumë më pak, ndërsa përmenden projekte shumë të mëdha, që nuk besoj që mundën me u realizuar me ato mjete sa janë caktuar. Konsideroj se propozimet dhe sugjerimet tona duhen të merren parasysh dhe të punohet.

kërkoj me intervenuar edhe me e pasuruar këtë dokument ashtu siç e meriton ky dokument strategjik për Prishtinën.

Leutrim Retkoceri tha se sa i përket Kornizës afatmesme buxhetore, është njëri nga dokumentet më të rëndësishme që e ka qeverisja e Komunës së Prishtinës, andaj mendoj se një dokument i tillë voluminoz për herë të parë vjen në afatin kohor, që nuk ka ndodhur tetë vite më parë. Është e rëndësishme që planifikimet dhe buxhetet të ndërtohen me planifikimet e nevojshme, në mënyrë që mos të ketë probleme qysh kemi pasur vitet e kaluara me suficit, mos realizim të projekteve dhe kthim apo humbje të mjeteve. Duhet pasur parasysh se Korniza afatmesme buxhetore i vendos vijat e trasha të projekteve, prandaj sa i përket projekteve, uroj që të gjitha projektet në këtë kornizë ta kenë performancën dhe një analizë dhe planifikim, sepse Prishtina sot e ka jashtëzakonisht të nevojshme realizimin e projekteve që tash më janë në këtë kornizë.

Endrit Zabërgja theksoi se ky dokument nuk përmban informata dhe arsyeshmëri ekonomike apo financiare, me shpalosje të veçantë për çdo kategori ekonomike, si tek të hyrat, grandet, pagat e mëditjet, mallrat e shërbimet, subvencionet dhe investimet kapitale.

Ky dokument duhet të ketë përmbajtje, strukturë, shpalosje specifike me objektiva konkrete si një dokument që i paraprinë Planit strategjik zhvillimor të Komunës.

Ky dokument me përmbajtje dhe strukturë më shumë ngjanë në rregullore të strukturës organizative të Komunës dhe fushë-veprimtarisë së drejtorive sesa të Kornizës afatmesme buxhetore dhe se kjo kornizë dëshmon se nuk kenë as program, por vetëm dëshira, dokument që nuk definojnë asgjë konkrete.

Violeta Salihu, në cilësinë e kryesueses së Komitetit për barazi gjinore, tha se duhet pasur parasysh se barazia gjinore është një prej vlerave thelbësore demokratike dhe është shtylla e pestë ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm. Ajo sugjeroi që t'i bëhet një analizë më e detajuar buxhetimit në të gjitha projektet e mëdha ideore që u cekën më herët, në mënyrë që të arrihet një rezultat për një analizë të impaktit gjinor.

Rita Zeqiri me diskutimin e saj kryesisht u fokusua rreth shpenzimeve të planifikuara të Drejtorisë së Sportit, duke thënë se kjo drejtori si investim kapital ka parashikuar që në tre vitet e ardhshme të ndërtohet një terren për sportin e triatllonit, me vlerë prej 550 mijë eurove. Kërkoj që të na sqarohet konkretisht se ky investim prej 550 mijë euro të shkojë drejtë ndërtimit të shtegut të biçikletave, atëherë kjo nuk qëndron, sepse triatlloni nuk zhvillohet si sport në shtigjet e biçikletave nëpër qytete.

Po ashtu, edhe investimi prej 7 milionë eurosh për sallën multifunksionale, a është në koordinim me nivelin qendror, sepse këto 7 milionë euro nëse investohen vetëm nga Komuna, atëherë projekti do të mbetet në gjysmë.

Rashit Gashi tha se sa i përket Kornizës afatmesme buxhetore, i gjithë orientimi dhe fokusi në këto vitet e ardhshme do të jetë kryesisht kryeqyteti dhe periferia e kryeqytetit, sidomos rruga "A", e cila është një rëndësi e veçantë edhe për neve që gravitojmë nga rrethinat.

Por ajo që duhet të cekim është që nëse nuk ka ndonjë zhvillim të qëndrueshëm edhe në zonat rurale, nuk i kushtohet një vëmendje e duhur, ne prapë se prapë do të jemi një barrë për kryeqytetin, pra do t'i lëmë fshatrat dhe do të gravitojmë në kryeqytet, kështu që mund të cekim se për shkak të një rruge, e cila nuk zgjat as 400 metra në një lagje të caktuar të fshatit Mramor, banorët u detyruan ta shesin thuajse të gjithë pronën, pjesën dërmuese, dhe të vazhdojnë për qytet. Po ashtu, në këtë fshat është më se e domosdoshme të jetë edhe ndonjë çerdhe, kështu që me një investim krejtësisht të vogël mund t'i bëjmë që ato të jenë në shërbim të komunitetit.

Ermal Osmani kërkoi të dijë se si është paraparë ndërtimi i aneksit në shkollën "Ismail Qemali", si është menduar, sepse ajo shkollë i ka 2879 nxënës dhe 81 klasa mësimi. Tani në aneksin që do të ndërtohet a do të bëhet shpërndarja e këtyre nxënësve aktual, apo është paraparë që të vijë nxënës të ri, e që besoj se do të jetë problem shumë i madh edhe për lagjen, e jo vetëm për shkollën dhe cilësinë e arsimit.

Gëzim Sveçla tha se sa i përket investimit për tribunën lindore të stadiumit "Fadil Vokrri", ashtu si është paraparë vështirë është i arritshëm, sepse ka kosto shumë të lartë. Sa i përket ndërtimit të sallës multifunksionale të "Pallati i Rinisë", për shkak të materialit të

pakompletuar, nuk kemi pasur mundësi të orientohe mi saktë se ku është ajo hapësirë, por megjithatë mendoj se është dashur të kihet pak më shumë kujdes.

Arbër Vokri u shpreh se po e shoh që është futur në Kornizën afatmesme buxhetore planifikimi për Spitalin e Prishtinës, por shum a e mjeteve që është ndarë për këtë projekt mendoj se është e vogël, ndaj dhe dyshoj se ky buxhet nuk ka me mjaftuar për me menaxhuar mirë shëndetësinë e Prishtinës. Po ashtu, do të ishte mirë që të investohet më shumë edhe në avancimin e diagnostikën, me i shtuar edhe disa laborator për analiza tjera e që deri vonë janë bërë në qytetet tjera.

Arianit Beqiri tha se sa i përket investimeve te pjesa e kulturës, si te Galeria e qytetit, ndërtimi i Sallës shumëfunktionale dhe të Teatrit modern, kërkoj të dijë se a ka ndonjë lidhshmëri kjo e Teatrit modern me Ministrinë, apo janë dy gjëra të ndryshme, edhe se a ka ndonjë plan që të vazhdohet të bëhet diçka me ish-Tjegulloren, a është ende brenda idesë së Manifestës, që ta shndërron atë hapësirë në një rën prej projekteve dhe ideve, për shkak se ne e dimë që Manifesta fillon në muajin tjetër. Po ashtu, edhe tek kjo pjesa, Liceu artistik, a është menduar që të jetë shkolla "Prenk Jakova", apo është diçka tjetër, e nëse jo, atëherë a ka ndonjë ide ose plan për ndërtimin ose krijimin e një hapësire sa më adekuate të shkollës "Prenk Jakova".

Ajet Brajshori theksoi se me ndërtimin e Liceut artistik do të kemi një shkollë krejt tjetër të tipit të artit, që ndoshta iu ka nevojitur edhe më herët Prishtinës. Do t'i kemi edhe shumë fusha të tjera të artit e jo vetëm si shkollë e muzikës, prandaj është edhe një investim i drejtë në tri vitet e ardhshme, që marrin shumën rreth 3 milionë e 780 mijë euro, ku do t'i kenë të gjitha objektet tjera përcjellëse, si lice, salla koncertale, salla të baletit, pastaj klasat e ushtrimeve vetanake, dhe vërtet do ta kthejmë edhe në fushën e kulturës edhe të arsimit Prishtinën, që meriton të jetë me emrin e plotë, Lice artistik në kryeqytetin e Kosovës.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë: Valbona Makolli, drejtore, Besianë Musmurati, drejtore, Izet Sadiku, drejtor dhe Përparim Rama, kryetar.

Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për, 12 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Korniza afatmesme buxhetore 2023 – 2025 (KAB).

Pika e katërt

Propozimvendimi për transferimin e mjeteve nga fondi i rezervës komunale.

Lidhur me Propozimvendimin për transferimin e mjeteve nga fondi i rezervës komunale, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtore.

Gëzim Sveçla kërkoi të dijë procedurën e përzgjedhjes së këtyre dy projekteve, se cilat kanë qenë kriteret që është caktuar, se këto mjete të cilat janë mbledhur prej fondit rezervë janë prej projekteve të ndryshme, të cilat janë të bllokuara për arsye të ndryshme.

Pse nuk është vazhduar me të njëjtat edhe pse është bërë pikërisht përzgjedhja e këtyre dy projekteve, këto që i kemi këtu në këtë propozimvendim?

Elmire Nikçi, tha se ne si grup i LDK –së, e kemi shqyrtuar propozimin për bartjen e këtyre mjeteve nga fondi rezervë dhe do të jemi pro këtij vendimi, duke marrë parasysh premtimet e LDK –së dhe kryetarit Rama gjatë fushatës zgjedhore, specifikisht për rrugën "A", për kolektorin, pastaj për trafikun alternativ, si për skuterë dhe biçikleta, e që këto projekte do të ndikojnë pozitivisht në jetën dhe mirëqenien e qytetarëve.

Leutrim Retkoceri tha se si grup parlamentar, duke pasur parasysh edhe kërkesën që propozimet të cilat i kemi pasur edhe më herët, kemi pritur që do të ketë një rishikim të buxhetit. Njëri nga opsionet të cilat ka qenë e mundshme ka qenë edhe këtu, që një shumë e mjeteve të ishte ndarë për ndërtimin e shtatores së heroit Adem Jashari në Prishtinë. Ne do ta votojmë këtë propozimvendim, në mënyrë që të mos humbim mjete drejt realizimit të projekteve, çka është shumë e dobishme sot për kryeqytetin e Kosovës.

Bahri Gashi tha se përderisa janë paraparë dy projekte të ndryshme, pse nuk janë bërë dy vendime por një vendim, prandaj nuk po e kuptoj këtë praktikë të punës.

Po ashtu, do të ishte mirë me u specifikuar që shuma e mjeteve prej 3 milionë e 500 mijë euro po jepet shtesë për rrugën "A", por mendoj se kjo shumë e mjeteve nuk është e mjaftueshme për realizimin e këtij projekti.

Sami Boroci kërkoi të dijë se a ka gjasa me pasur bartje buxhetore brenda këtij viti.

Po ashtu, në vitin e kaluar për buxhetin e vitit 2022 kemi ndarë një shumë të caktuar për ndërtimin e stadiumit në Hajvali, e ato mjete kanë dalë në rezervë për shkak të një kontesti pronësor projekti nuk ka mundur me u realizuar dhe tash është ndarë pronë e re. Ekziston një pronë që është ndarë prej Drejtorisë së Pronës dhe Drejtorisë së Sportit, a munden të përdoren ato mjete në kuadër të këtij projekti.

Gjithashtu, dua të dijë pak më shumë rreth konceptit të blerjes së biçikletave, por si kanë me operuar si projekt në Prishtinë.

Endrit Zabërgja tha se e përgëzoj GP të PDK –së për iniciativën e ngritjes sa më të shpejt të shtatores së Adem Jasharit, por në këtë KAB të Prishtinës nuk kemi hasur as në planifikim të shpalesjes për buxhetin e përgjithshëm gjinor, ku këtë kategori e rregullon Ligji për barazi gjinore. Diskutimi i deritanishëm ishte në raport të mesazhit politikë dhe vazhdoj me besuar prapë që ka shumë çështje profesionale për të cilat do t'i drejtohem ekzekutivit.

Lidhur me vërejtjet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Valbona Makolli, drejtoreshë.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për, 1 kundër dhe 14 abstenime, u miratua Vendimi për transferimin e mjeteve nga fondi i rezervës komunale.

Pika e pestë

Propozimvendimi për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo - arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës.

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo - arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Besianë Musmurati, drejtore.

Gëzim Sveçla shprehu dilemën në orientimin e vetëm të dy personave, të cilët do ta kenë vëllimin e punëve të mëdha në të gjitha komisionet, andaj në këtë drejtim e kemi frikën se a kanë me arritur me pasur vlerësimin meritore, për shkak se ata do të bëjnë më se 500 intervista. Në anën tjetër, përgëzoj për këtë çështjen e transparencës, po presim të na ftoni dhe të filloj procesi, të jenë punësime meritore.

Ajet Brajshori tha se më vjen mirë që tani kemi një rrugë shumë transparente dhe profesionale drejt formimit të komisionit, apo themelimit të komisionit për intervistimin e drejtorëve. Ngritja e kapaciteteve profesionale është njëra ndër shtyllat kryesore që garanton arsim cilësor, dhe e përgëzoj drejtoreshën Besianë për transparencë dhe një hap në këtë drejtim, duke bashkëpunuar edhe me Zyrën britanike, duke i respektuar potencialet brenda që i ka edhe Drejtoria e Arsimit. Ju bëjë thirrje të gjithëve të investojmë në arsim, aq më shumë që investojmë në arsim të kemi një arsim të shëndoshë, ta kem një shtet të fortë dhe të shëndoshë. Po ashtu, dua të ju njoftoj se drejtorët nuk do të jenë ata që zgjidhen 4 vjet dhe me e pasur aty një komoditet, por çdo vjet do të matet performanca e punës së tyre, mbështetur në Planin zhvillimor të punës së shkollave.

Leutrim Retkoceri shprehu mendimin se formimi i këtij komisioni është rruga e duhur kur po përfillet organi më i lartë brenda Komunës së Prishtinës, që është Kuvendi i Komunës dhe ky komision po vjen që ta marrë besimin dhe betimin nga Kuvendi i Komunës.

Ndihem mirë me komentet e kolegëve paraparak dhe për punën e madhe që e ka bërë ekzekutivi i Komunës së Prishtinës, nga kryetari Rama, nënkryetarja Donjeta, drejtorja Besianë dhe gjithë kolegët tjerë. Po ashtu, është hera e parë që ky komision po bëhet në përbërje edhe nga ambasada britaneze, që është një garanci se do të ketë profesionalizëm.

Valbona Ajeti tha se edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozimvendim për caktimin e komisioneve për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave të komunës së Prishtinës.

Sami Boroci tha se arsimi është dashtë me qenë njëra prej temave kryesore që duhet me trajtuar. Po më vjen mirë që ka lëvizje të tilla. Tani besoj se është koha me i depolitizuar shumë këto nivele, dhe me të vërtetë me garantuar dhe me siguruar proces të mirë dhe transparent. Kishte me qenë mirë që me i dërguar njoftimet kur janë intervistat, të paktën dikush prej neve me qenë si vëzhgues në raste të caktuara.

Endrit Zabërgja tha se edhe ne po ashtu e konsiderojmë si lëvizje pozitive në raport me përzgjedhjen e mësimdhënësve, vetëm dëshirojmë të ju urojmë punë të mbarë dhe pa dyshim në të ardhmen do ta vëzhgojmë edhe përzgjedhjen që do ta bëjë ky komision.

Fiknete Bejta tha se ne sot po diskutojmë për shtyllën më të rëndësishme të shtetit dhe shoqërisë, siç është arsimi, prandaj falënderoj drejtoreshën për qasjen që e ka ndaj këtij sektori shumë të rëndësishëm të shtetit për transparencë dhe përgjegjësinë që ka marrë. Zbatimi i Ligjit për arsimin parauniversitar, që na është sjellë në Kuvendin Komunal për miratim komisionin për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo - arsimore dhe aftësuese në Prishtinë, është një indikacion që kjo qeveri komunale ka në plan të zgjidh problemet e arsimit.

Drejtoria e Arsimit duhet të organizojë reforma edhe në burimet njerëzore, duke organizuar trajnime për qasjen e mësimdhënësve dhe menaxherëve të shkollave ndaj nxënësve. Nuk është reformë vetëm trajnimi në zbatimin e kurrikulave, por edhe qasja ndaj fëmijëve që ju duhet një edukim, prandaj te menaxherët e shkollave me këtë komision të ri, mendoj se ka mjaftueshëm ekspertë t'i jepet prioritet edukimit dhe fëmijës në qendër e jo si objekt, por si subjekt.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Besianë Musmurati, drejtoare.

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për dhe 13 abstenime, u miratua Vendimi për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendësrektorëve të institucioneve edukativo – arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Projektregulloren për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksì.

Lidhur me Propozimvendimin për konsulta paraprake publike lidhur me Projektregulloren për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksì, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Ilirik Musliu, drejtor.

Gëzim Sveçla, ngriti dilemë rreth kësaj projektregulloreje, i cili kërkoi të dijë se kush ka punuar në këtë rregullore, kush janë ekspertët, çka është marrë si model, çka ndryshon prej rregullores aktuale dhe a mendoni se shumica prej kritereve, siç janë çështja e modernizimit, kalimit të arritjes së standardeve mos po e vështirësojnë shumë edhe po i qesim në një pozitë shumë të palakmueshme jo vetëm këto shoqatat e auto-taksive, sidomos të taksive individuale që janë të regjistruara, për shkak se janë kritere bukur të rënda për realitetin të cilin jetojmë.

Duke marrë parasysh këto, është vështirë që të zbatohet kjo rregullore në këtë mënyrë se si na është paraqitur.

Fisnik Osmani tha se për ne është shumë me rëndësi që këtë projektregullore ta trajtojmë në mënyrën më serioze të mundshme dhe këtë e kemi diskutuar në grupin tonë parlamentar, natyrisht se do ta japim votën pro që të futet në diskutim publik prej 30 ditësh, mirëpo i kemi disa sugjerime, disa vërejtje, të cilat jemi të përkushtuar t'i japim gjatë kësaj periudhe. Po ashtu, jemi të interesuar që t'i shohim modalitetet të cilat sa më lehtë ta kalojmë në këtë fazë, pastaj pas kësaj periudhe do të japim kontributin tonë.

Leutrim Rekoceri, tha se është e vërtetë që për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksì ka qenë një çështje e pazgjidhur, prandaj ne kemi probleme të natyrave të ndryshme që duhet ti drejtojmë kjo rregullore, dhe është mirë që është e mbështetur edhe në programet dhe parimet e fushatës, që realisht kanë qenë premtime zgjedhja e kësaj problematike në kohën ma të afërt.

Bahri Gashi tha se edhe ne si grup parlamentar e kemi analizuar këtë propozimvendim dhe kemi disa vërejtje. Kjo projektregullore na është sjellë tejet e mangët, por besoj se më vonë do të kompletohet. Ne konsiderojmë se përderisa është koha e pushimeve verore, kjo projektregullore të dalë në diskutim publik në muajin shtator.

Gjithashtu, do të ishte mirë që ne t'i kemi disa informata, si p.sh. sa kompani operojnë në komunën e Prishtinës, sa taksi individuale, sa licenca i ka lëshuar Komuna e Prishtinës, sa janë aktive, sa janë shitur, sa janë blerë, kush i ka shitë dhe kush i ka blerë.

Sa i përket taksive ilegal duhet t'iu bëhet zgjidhje që mos të mbesin rrugëve. Kishte me qenë mirë me ftuar edhe Sindikatën e taksistëve privat.

Gëzim Mehmeti tha se kjo rregullore ka qenë e domosdoshme për shkak të evoluimit që po ndodh, sidomos sa i përket rrethanave të evoluimit në industri të automobilave dhe rrethanat të cilat mbizotërojnë në Kosovë. Lidhur me këtë projektregullore vërejtje bëri kryesisht për nenin 6 që parasheh pajisjen me arkën fiskale, andaj ceku se këtu është një paqartësi dhe kjo duhet të diskutohet, sepse TVSH nuk paguajnë taksistët, janë të liruar nga TVSH-ja. Po ashtu, vërejtje kishte edhe rreth kostos së licencimit.

Endrit Zabërgja po ashtu, tha se duke pasur parasysh krizën ekonomike në të cilën po kalon vendi ynë, në veçanti për taksitë privat të cilët vozitin, mendoj se do të duhej të bënim ndonjë ndryshim, apo ndonjë zbritje në raport me lejen e tyre.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Ilirik Musliu, drejtor.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, 2 kundër dhe 13 abstenim, u miratua Vendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Projektregulloren për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksi.

Pika e shtatë

Informatë lidhur me mbjelljet pranverore në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës

Lidhur me informatën për mbjelljet pranverore në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Plator Gërdovci, drejtor.

Feim Osmani tha se ky dokument sot është vetëm informatë e thjeshtë, për të cilën ne mund të hapim debat, mundë të bëjmë debat i cili do të na shërbente për vite tjera, por tash për tash ka ndikim zero në këtë proces, sepse mbjelljet pranverore kanë përfunduar. Komuna e Prishtinës, ka sipërfaqe të mëdha që mundë të shfrytëzohen për bujqësi në numër të mjaftueshëm, ka edhe bujq në numër të mjaftueshëm, por ne duhet t'i përkrahim dhe të bëjmë atraktive punën e tyre, sigurisht që do të tregojnë rezultate shumë më të larta se kaq. Edhe te buxhetet vjetore shihet së në 800 000 deri një milion euro buxhet është e pamundur me iu dalë në ndihmë aq sa kanë nevojë edhe aq sa është e paraparë për bujqit. Ai kërkoi që këto informata, sidomos që i përkasin fushës së bujqësisë, të vijnë para se të ndodhë, p.sh. ne tash kemi hyjmë në fazën e mbjelljeve vjeshtore, pra këto të diskutohen në shtator e jo të mbetet për muajin nëntor kur përfundon faza e mbjelljeve.

Milazim Vitija tha se është e vërtetë që bujqit i kemi në gjendje të rëndë, për shkak të ngritjes së çmimeve. Edhe ata bujq që i kemi veç kanë filluar me e braktisur veprimtarinë

Faqe 1 nga 23

bujqësore për shkak të ngritjes së çmimeve, prandaj kishte më qenë mirë që këta fermerë edhe bujq të përkrahen në forma të ndryshme.

Mekanizmi bujqësor është shumë i vjetruar, do të kishte qen mirë të parashihej vaksinimi i bagëtive, si dhe qenve të cilët mbahen në shtëpi. Do të duhej të merreshin masa për kompensimin e dëmeve të kulturave bujqësore të shkaktuara nga breshri.

Muhamet Selmani theksoi se është e vërtetë që situata e fermerëve në komunën e Prishtinës nuk është e mirë, sidomos në aspektin e përkrahjes së subvencionimit krejt thjesht, për arsye të buxhetit të vogël edhe mos vullnetit dhe dëshirës jo vetëm të drejtorit, por edhe të institucioneve komunale për t'i përkrahur, prandaj dhe është shumë e rëndësishme të fokusohemi dhe të gjejmë metodat ku do të mundë të ngritën fonde, ose të grumbullojmë fonde dhe të mund t'i përkrahim fermerët. Do të ishte mirë të krijohet edhe fondi që do t'i ndihmonte fermerët për sigurimin paraprak të mbjellave të tyre bujqësore që do të mbulohej nga ky fond, i cili në një farë mënyre do të krijonte një siguri edhe për këto të mbjella që janë të domosdoshme, e sidomos në kohërat dhe krizat që po kalojmë.

Sami Boroci tha se buxheti që është paraparë për Sektorin e bujqësisë, është shumë vështirë të arrijë të përkrahë anën e Gollakut dhe anë të tjera të Prishtinës, që janë zona periferike, kështu që ne si Kuvend duhet me e pasur një dakordim, që në këtë resor me rritur buxhetin. Besoj se ka hapësirë buxhetore me u rritur vlera e buxhetit.

Do të insistoj që për sektorin e bujqësisë të jetë një buxhet më i lartë.

Pëllumb Bajçinvci e falënderoi drejtorin për të arriturat, për aktivitetin e tij të pandalshëm rreth disa projekteve në Sektorin e bujqësisë. Ai kryesisht u përqendrua për mbjelljet në kryeqytet dhe në disa pjesë periferike, të cilat i ka kryer Drejtoria e Parqeve në periudhën mars - qershor në kultivimin dhe regjenerimin e sipërfaqeve të gjelbra.

Fiknete Bejta përgëzoi drejtorin për punën që e ka bërë dhe që po ka një qasje ndryshe më fermerët dhe më bujqit në përgjithësi. Lidhur me këtë tha se kam vërejtje te subvencionimi i bujqësisë, te thirrjet, ku theksohet "me i subvencionuar fermerët e mëdhenj". Ne si drejtori, si Komunë, si Kuvend duhet me menduar edhe për fermerët e vegjël, andaj i kisha sugjeruar drejtorit që, në të ardhmen, ta sjellë në Kuvend një linjë buxhetore edhe për fermerët e vegjël, sepse ne duhet t'i ndihmojmë edhe ata që kanë pak tokë.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Plator Gërdovci, drejtor.

U konstatua se u përkrah Informata lidhur me mbjelljet pranverore në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës.

Pika e tetë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor në lagjen "Kolovicë e Re", në Prishtinë.

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor në lagjen "Kolovicë e Re", në Prishtinë, të pranishmit në pika të shkurtra i

informoi Besianë Musmurati, drejtore dhe Florim Krasniqi, zyrtar i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Nora Kelmendi, bëri vërejtje për këtë propozimvendim, duke thënë se në parcelën kadastrale, nr. 875/1, thuhet se kjo parcelë shtrihet në zonë të destinuar për banim individual dhe shtrohet pyetja se a mundë të ndryshohet ky destinim i parcelës jo sipas praktikave, por sipas legjislacionit në fuqi, kjo vlen edhe për "Kolovicën e Re dhe për Kolovicën e Vjetër".

Po ashtu, sa i përket propozimvendimit të Kolovica e Vjetër, janë 4 parcela të ndara në 5,4,6 për 0, 5,4,7 për 0, 5,4,8 për 0 dhe 5,4,9 për 0. Po ashtu, edhe te Mati 1 është një parcelë me disa ndarje, 8,7,5,1. Ceket se është pronë shoqërore, a bënë pjesë edhe kjo parcelë në këtë vendim, a ka me u ndërtuar institucioni parashkollor edhe në këtë parcelë apo vetëm në këto katër parcela.

Ajet Brajšhori tha se sa i përket këtij propozimvendimi, ne jemi të gëzuar që kudo në lagjet e Prishtinës me u bërë ndërtimi i çerdheve, sepse ata fëmije pa ndasi janë fëmijët tanë, megjithatë kemi një obligim qytetar dhe institucional.

Nuk jemi kundër ndërtimit të këtyre dy çerdheve në Kolovicën e Re dhe të Vjetër, por nëse marrim pjesë tjera të qytetit, siç është "Kodra e Trimave", nuk e kemi asnjë çerdhe publike, por edhe në fshatra, prandaj në një të ardhme ne të gjithë bashkërisht të mendojmë shumë mirë edhe për këtë pjesë të qytetit dhe për pjesë tjera periferike.

Leutrim Retkoceri tha se çerdhet të cilat janë duke u ndërtuar, qoftë edhe mes Kolovicës së Vjetër dhe Kolovicës së Re, kanë një distancë 2. 5 kilometra të rrugës dhe është mirë që në atë zonë po ndërtohen ato çerdhe publike.

Sa i përket kësaj të "Mati 1", e di që është e planifikuar aty edhe një shkollë dhe pikërisht për shkak të problemeve pronësore nuk ka mundur të realizohet dhe është bartur për disa vjet edhe në buxhet ndërtimi i asaj shkolle.

Si grup parlamentar do ta përkrahim këtë propozimvendim dhe do të jemi insistues që edhe në seancat të tjera, edhe buxhetin e shtatorit për vitin 2023, të kemi më shumë mjete që të dedikohen në shpronësimin e pronave, në mënyre që të krijojmë kushte në ndërtimin e çerdheve dhe shkollave.

Kushtrim Mushica tha se edhe ne si grup parlamentar e mbështesim këtë propozimvendim për miratim.

Sami Boroci tha se nuk do ta kundërshtojmë një iniciativë të tillë, por po dua me e ngritur si temë, me e sqaruar lokacionin te "Mati 1". Kërkoj të dijë se në cilën pjesë është, a është brenda lagjes "Kodrina" apo jashtë saj. Po ashtu, kisha dashtë të dijë se cili është plani për lagjet tjera, konkretisht për lagjen "Kodra e Trimave", për lagjen "Arbëria", për Hajvalinë, për Veternikun, sidomos lagjet e reja që po rriten çdo ditë.

Kur mundet me pasur Hajvalia një çerdhe publike, e ka një çerdhe me bazë në komunitet që nuk i plotëson nevojat as për se afërmi një lagje që me të vërtetë po rritet jashtëzakonisht shumë.

Endrit Zabërgja e përgëzoi ekzekutivin për këtë hap, duke thënë se, për çështje të tilla uroj gjithmonë të kemi nguti, në mënyrë që pronat publike të jenë në shërbim të shkollave dhe çerdheve.

Po ashtu, edhe ne banorët e Lagjes së Muhaxhirëve dëshirojmë ta kemi një çerdhe të Komunës.

Gëzim Sveçla ngriti shqetësim, duke thënë se a mjafton ky votimi që ne sot e bëjmë për me ndodh ky ndërrimi i shfrytëzimit, apo duhet diçka të veçantë të bëjmë e që më pastaj mos të na paraqitet problemi në MAPL, të jemi komplet në rregull.

Në përgjithësi e përshëndesim këtë veprim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, konkretisht Ministrinë e Arsimit, që ka kërkuar një hapësirë për ndërtimin e një institucioni parashkollor, si dhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që ka arritur me siguar fondet nga IPA, po ashtu gatishmërinë dhe vullnetin e BIK-së, për me e financuar ndërtimin e një çerdheje.

Ermal Osmani tha se lagjja "Bregu i Diellit" është një lagje e madhe, e mbipopulluar dhe ekzistimi i dy çerdheve nuk i plotëson kushtet për pranimin e shumë familjeve të cilët mbesin pa i regjistruar fëmijët e tyre në çerdhe publike. A është menduar ndonjëherë që në oborret e këtyre dy çerdheve të shihet mundësia e shtimit të anekseve?

Dasmor Durmishi tha se sa i përket planifikimit të ndërtimit të tri çerdheve, është më se e nevojshme që të ketë sa më shumë çerdhe, pra ku ka më të nevojshme se ne lagjen "Kodra e Trimave" me u ndërtuar një çerdhe.

Amir Simnica tha se jam i thirrur të flasë për Lagjen e Muhaxhirëve, për një lokacion për të cilin ne kemi biseduar, që i plotëson kriteret edhe për nga dendësia edhe për nga nevoja se nuk e ka asnjë çerdhe publike në këtë lagje. Lidhur me këtë çështje, ceku se duhet të jetë një sinjal i qartë për ekzekutivin, që të gjitha problematikat që mundë të lindin me pronat të cilat i ka Komuna brenda Lagjes së Muhaxhirëve, që ato probleme të fillojnë ose me dëgjime publike, ose të vihet në funksion ekzekutivi i Komunës.

Duhet të merret seriozisht kjo punë, të vihet në lëvizje ekzekutivi i Komunës, të gjitha paqartësitë ose keqpërdorimet e dikujt që kanë bërë me pronat publike, të evitohen që të mos mbetet komuniteti në fjalë peng i këtyre punëve.

Agron Canolli u shpreh se duke pasur parasysh që fëmijët e lagjes "Kolovicë e Re" dhe "Kolovicë e Vjetër", si dhe duke e përfshirë edhe lagjen "Mati 1", ende nuk kanë qasje në programet formale të edukimit në fëmijërinë e hershme, dhe duke pasur parasysh se njëra ndër kërkesat kryesore të këtyre banorëve të Kolovicës dhe Matit 1, ka qenë ndërtimi i çerdhes, duhet edhe ne si përfaqësues të qytetareve të sigurojmë që fëmijët, pa dallim të kenë qasje të barabartë në shërbimet e ofruara në çerdhet publike.

Gëzim Mehmeti shprehu mospajtim me atë që u cek, se në tri vitet e fundit nuk është ndërtuar asnjë çerdhe. Lidhur me këtë ai njoftoi se gjatë tre viteve të fundit janë ndërtuar tri çerdhe, që janë: "Milingonat" në "Kodrën e Trimave", është ndërtuar, ka përfunduar, janë vendosur aty fëmijët, "Cicërimat" në lagjen "Kalabria", si projekt i përfunduar, "Yllkat" të Blloku, d.m.th. tri çerdhe në tri vitet e fundit kanë përfunduar dhe janë në shërbim të fëmijëve.

Arbër Vokri falënderoi Qeverinë e Republikës së Kosovës që e ka mundësuar ndërtimin e këtyre tri çerdheve, po ashtu edhe BIK-në, që ka shprehur gatishmëri me sponsorizuar ndërtimin e këtyre çerdheve. Lidhur me këtë tha se do të ishte mirë që të mendohet edhe për ndërtimin e një çerdheje në lagjen "Dardania", pasi që vetëm me një çerdhe që ka kjo lagje nuk i plotëson nevojat e komunitetit.

Rashit Gashi u përqendrua rreth edukimit të hershëm në zonat rurale, përkatësisht në fshatrat përreth Prishtinës. Lidhur me këtë si shembull konkret veçoi fshatin Mramor, ku janë dy anekse të shkollave të mësimit klasor, të cilat thuhet janë të pashfrytëzuara, që këto hapësira të dedikohen për çerdhe. I bëjë ftesë publike drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit, ta bëjë një vizitë në atë lokalitete dhe t'i vizitojë personalisht ato dy anekse të shkollave, ku me një investim minimal mundë të funksionalizohen qoftë edhe me bazë në komunitet, dhe të jenë në shërbim të komunitetit të asaj pjese.

Fiknete Bejta kërkoi që për hir të transparencës, është më se i nevojshëm që të bëhet procesi i digjitalizimit të aplikimit për çerdhe, pasi që e dimë se po kemi shumë keq përdorime në çerdhet e Prishtinës.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Besianë Musmurati, drejtoreshë, dhe Valbona Makolli, drejtoreshë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 42 vota për, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor në lagjen "Kolovicë e Re", në Prishtinë.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor në lagjen "Mati 1", në Prishtinë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 44 vota për, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor në lagjen "Mati 1", në Prishtinë.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor në lagjen "Kolovicë e Vjetër", në Prishtinë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 43 vota për, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor në lagjen "Kolovicë e Vjetër", në Prishtinë.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu "KOSTT", SHA.

Lidhur me Propozimvendimin për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu "KOSTT", SHA, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Doruntinë Maloku, drejtoare.

Nora Kelmendi, lidhur me këtë propozimvendim ngriti shqetësim, duke pyetur se si është lëshuar leja për Qendrën tregtare, pra kemi të bëjmë me një qendër të madhe tregtare dhe leja e ndërtimit, kur dihet se ajo trafo rrezikon jetën e njerëzve, dhe për këtë dikush duhet të mbaj përgjegjësi, dhe tani vjen tek ne, duhet ta dislokojmë këtë trafo për shkak se është lëshuar leja e ndërtimit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Jeta Rafuna tha se ne si Grup parlamentar e mbështesim kërkesën e KOSTT-së për zhvendosjen e shtyllave elektrike, duke konsideruar që kjo kërkesë e këtij institucioni shumë kredibil, ka të bëjë me interesin e përgjithshëm publik dhe sigurinë e qytetarëve për furnizim me energji.

Gëzim Mehmeti ngriti çështjen që ka të bëjë me interesin publik, duke thënë se sa i përket këtij propozimvendimi, që kemi hasur në vështirësi dhe rrethana të tilla me KOSTT-në, kërkoi që të mbrohet interesi publik, mos t'ju lejojmë që ne të japim diçka e të mos marrim në këtë rast.

Gëzim Sveçla shprehu mendimin se, duke cekur që në këtë rast çështja nuk ka të bëjë me interesin publik, mendojmë se është duke ju kryer favor dikujt tjetër dhe në këtë propozimvendim nuk mund ta votojmë, do të votojmë kundër, për shkak se gjeneza e këtij problemi është e mëhershme, do me thënë në qeverisjen e kaluar.

Rashit Gashi tha se nga praktika e mëhershme rreth përvojës time 8 vjeçare në KEK dhe KEDS, nuk e di që ka ndodhur diku, që në Komunën e Prishtinës në emër të një biznesi i cili ka aplikuar në KOSTT, t'i krijohet favore dikujt tjetër. Kjo nuk është interesi i përgjithshëm, se një biznes privat i ka rrezikuar asetet e KOSTT-it, ka bërë ndërtim nën linjat e tensionit të lartë, ku i ka rrezikuar asetet dhe furnizimin me energji elektrike, e që është në kundërshtim me të gjitha normat rregullative.

Lidhur me vërejte e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Doruntinë Maloku, drejtoare.

Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për dhe 12 kundër, u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu "KOSTT", SHA.

Pika e dymbëdhjetë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e një memoriali dhe çezme në Lagjen e Muhaxhirëve.

Amir Simnica tha se për ndërtimin e këtij memoriali në Lagjen e Muhaxhirëve, është kërkesë e Shoqatës së Muhaxhirëve të shqiptarëve mbarëkombëtar, të cilët janë të përfaqësuar nga z. Asllan Qyqalla, kryetar i Shoqatës dhe Orhan Ramadani, sekretar i Shoqatës.

Drejtoria e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës pas rishqyrtimit të kërkesës dhe provave të bashkëngjitura, ka dhënë pëlqim për vendosjen, ndërtimin e kroit publik komfor situacionit të bashkëngjitur në këtë shkresë.

Arbër Vokri tha se në mandatin e kaluar, së bashku me disa kolegë, kemi tentuar disa herë që me e shtyrë përpara këtë propozim të Shoqatës Mbarkombëtare të Shqiptarëve Muhaxhirë. Si Grup i asamblistëve të LVV-së shpresojmë që nuk do të ketë ndonjë problem me planin urbanistik, që të mos kthehet pra ky propozim për ndarje të asaj parcele. Konsideroj se, një monument i tillë do ta mbaj gjallë kujtesën edhe do t'i shërbejë mbase edhe politikëbërjes në argumentimin më të mirë në raporte ndërkombëtare.

Jeta Rafuna - Hasani tha se e përkrahim këtë propozimvendim dhe shumë mirë që po gjen përkrahje nga të gjithë ne, edhe nga kryetari dhe nga Komuna.

Granit Geci tha se ky memorial pa dyshim se do ta riprezantojë një pjesë të një memorie historike, e cila pa dyshim se dita ditës po cenohet, duke mos qenë prezentë në atë pjesë. Ne do ta vendosim një lloj monumenti, një lloj gurthemeli që e ardhmja të tregojë se si kjo pjesë e historisë sonë ka ndodhur para shumë vitesh, pra prej vitit 1876-78, dhe ne e kemi për detyrë që të përkujdesemi që gjeneratat e reja të dinë më shumë për këtë tragjedi që ka ndodhur në atë kohë. Këtë propozimvendim e mbështesim për miratim.

Bahri Gashi tha se edhe ne këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

Endrit Zabërgja ushpreh se e përhëndes këtë iniciativë, e konsideroj të domosdoshme, që pa dyshim do të shërbejë si fakt historik i gjenocidit serb të shek. XIX dhe programit shovinist "Narqetanja" që i dëboi më shumë se 200 mijë shqiptarë dhe i shkatërroi rreth 840 fshatra shqiptare. Uroj që të jetë ky monument i pasuruara me fakte dhe argumente historike, në mënyrë që të kemi çfarë të dëshmojmë para të gjithë botës për atë fatkeqësi që i ka ndodhur me shekuj popullit shqiptar.

Ajet Brajshori tha se vërtetë kjo është historia jonë, sa është e dhimbshme është edhe krenare, dhe të flasim pas 140 vjetëve për eshtrat e ish-vëllezërve, motrave, prindërve tanë është mjaft e dhimbshme, por është shumë e fuqishme se nuk e kemi harruar. Ideja për Lagjen e Muhaxhirëve është sinonim i Prishtinës, është emblemë e Prishtinës, është dëshmi historike se padrejtësisht jemi shpërngulur më se 636 fshatra nga viti 1876 deri në vitin 1884.

Arianit Beqiri tha se në hartimin e tekstit të këtij memoriali duhet të kemi parasysh edhe numrat, shifrat dhe arsyen mbase politike, historike që ka qenë, pse ata janë detyruar t'i lëshojnë vatrat e tyre.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 33 vota për, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e një memoriali dhe çezme në Lagjen e Muhaxhirëve.

Pika e trembëdhjetë
Pyetje dhe përgjigje

Feim Osmani për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit.

Faqe 17 nga 23

- Një çështje që është problem për transportin e udhëtarëve kryesisht për fshatrat e veriut të Prishtinës, pasi që veç tani transporti publik ka shënuar ngritjen në aspektin e çmimeve jashtëzakonisht shumë dhe këto pjesë të ndjeshme të shoqërisë, siç janë nxënësit, pensionistët, nuk e kanë qasjen në transportin publik. Kisha dashur që të bëhet një zgjidhje tjetër jashtë asaj që e parasheh Plani i mobilitetit.
- Çështja tjetër është për kanalizimet. Për fshatin Rimanishtë ka qenë e planifikuar me bartje të buxhetit, nuk e di tani më nuk e pash që është as në kornizat afatmesme buxhetore, as në planifikim për buxhetim të vitit 2023.
- Një sqarim për shkollën e fshatit Vranidoll, ku ndërtimi i kësaj shkolle është dashur të përfundojë në shtator të këtij viti. Kërkojmë sqarim se ku janë procedurat, a do të kenë mundësi që këtë vit të vazhdojnë nxënësit aty, apo prapë se prapë do të vazhdojnë në Tenezhdoll, që kushtet janë shumë të këqija?
- Pastrimi i rrugës Besi - Rimanishtë a ka mekanizëm Prishtina, përmes cilësdo ndërmarrje publike që ta bëjë pastrimin e saj nga shkurret që janë zgjatur anash saj dhe e kanë vështirësuar jashtëzakonisht shumë komunikacionin. Edhe njëherë kam bërë pyetje por nuk është reaguar në këtë aspekt.
- A do të bëhet rregullimi i rrugicave në fshatin Vranidoll, të cilat kanë qenë të projektuara?
Besoj që do të duhej gjetur buxhet për këtë vit, ose së paku vitin tjetër me i realizuar.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Osmani, sqarime shtesë dhanë Valbona Makolli, drejtore, dhe Besianë Musmurati, drejtore.

Endrit Zabërgja, për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Është shqetësim i qytetarëve të Prishtinës, konkretisht banorëve të lagjes "Tophane", rruga "Lidhja e Prizrenit", ku pothuajse një pjesë e madhe e trotuareve është e mbushur me mallra dhe dyqanet private që e kanë uzurpuar trotuarin. Është shqetësim i banorëve të lagjes, sepse çdo ditë ka aksidente dhe rrezik për fëmijët të cilët e frekuentojnë shkollën fillore "Meto Bajraktari" në atë lokacion.
- A ka ndonjë afat kohor, se kur do të ndriçohen rrugët e Lagjes së Muhaxhirëve, pasi që një pjesë e tyre nuk kanë ndriçim?

Lidhur me shqetësimet e ngritura nga z. Zabërgja, sqarime shtesë dha Përparim Rama, kryetar.

Arbnora Berisha, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Përveç rritjes së çmimeve të linjave të transporteve private, të gjitha fshatrat përreth kanë edhe reduktime të orareve, nuk kanë orar të rregullta të transportit. P.sh. për fshatin Prugovc, apo Barilevë, është 10 minuta prej Prishtinës, ta ketë autobusin e fundit në orën 19:00 disi është jo e logjikshme dhe çdo 2 orë. Tani prej muajit qershor deri në shtator, kur nuk kemi nxënës në shkollë, vetëm në çdo 2 orë ka transport.

- Po ashtu, është kërkesë e banorëve të fshatit "Trudë", për vendosjen e pengesave në rrugën "Andrea Kushi", pasi lëvizja e shpejt e automjeteve rrezikon banorët. Po në këtë rrugë banorët kërkojnë edhe ndriçimin publik.
- Kërkesa tjetër e tyre është që të merren masa e të ndërtohet një muri mbrojtës për ndalimin e shembjes së dheut në rrugën "Sanxhaku i Nishit".
- Banorët e fshatit "Prugovc" afër rrugës "Selman Berisha", kërkojnë rregullimin e saj si dhe ndërtimin e një muri mbrojtës për parandalimin e rrëshqitjes së dheut, pasi që në kohën e dimrit rruga bëhet vështirë e kalueshme.
- Ndriçimi që është bërë në Gërmë, përcimi i rrymës që shkon përgjatë shtyllës elektrike nuk është mbyllur ashtu si duhet dhe është shumë afër tokës, që paraqet rrezik, sidomos për fëmijët. Kërkoj që kjo çështje të merret parasysht.

Petrit Reçica, për Kryetarin e Komunës:

- Bizneset hoteliere dhe gastronome a do të lirohen sivjet nga obligimi ndaj Komunës për shfrytëzimin e hapësirave publike në kryeqytet?
- Kur do të jetë gati Rregullorja për gastronominë, që do ta rregullonte orarin e punës së lokaleve. K kështu do të ishte mirë që të gjendet një zgjidhje konkretisht për lejimin e muzikës në këto lokale deri në orët e vona.

Lidhur me çështjet e ngritura nga z. Reçica, sqarime shtesë dha Përparim Rama, kryetar/

Bahri Gashi, për kryetarin e Komunës, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Si qëndron çështja e një parkingu te QKUK-ja, pyetje që e kam shtruar edhe në mbledhjen e kaluar, pra me çfarë baze i jepet prona publike biznesit privat, sepse ai është biznes privat e ajo pronë është e Komunës?
- Ekzistojnë tri fusha të tenisit tek lagja ime që i ka bërë Komuna e Prishtinës para nja 10 vjetëve e tani kishin kaluar në menaxhim të disa klubeve private të tenisit dhe tani qytetarët po paguajnë që të hyjnë të luajnë tenis aty. Thuhet se këtë hapësirë e menaxhon ndërmarrja "Sport Marketing". Kërkoj të dijë se në bazë të çfarë kontrate ju ka dhënë ajo hapësirë me qira atyre.
- Banorët afër rrugës "Adem Selmani" kërkojnë që të rregullohet rrejtja e kanalizimit, pasi që ai kanalizim ka shpërthyer dhe aty kundërmon erë e rëndë.
- Shoqata "Hendikos" këkon që mundësisht t'iu bëhet një parking për parkimin e automjeteve për nevojat e shoqatës.

Lidhur me pyetjet dhe shqetësimet e ngritura nga z. Gashi, sqarime shtesë dhanë Përparim Rama, kryetar, dhe Valbona Makolli, drejtoreshë.

Gëzim Sveçla, për kryetarin e Komunës, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- A ka ndryshuar traseja e rrugës "A", pasi që ka kërkesa të qytetarëve që traseja e kësaj rruge ka ndryshua nga ajo që ishte më parë?

- Çështja për pllakën përkujtimore, me këtë dokumentacionin veç tani janë njoftuar shefat e grupeve parlamentare.
- Ka disa zëra se menaxhimi i stadiumit të qytetit "Fadil Vokrri" do të kalojë në menaxhimin e ndërmarrjes "Sport Marketing" dhe duhet pas shumë kujdes në këtë çështje, sepse është tejet e ndjeshme.
- Orari për mbledhjen e mbeturinave dhe furnizimi për dyqane deri më tash nuk ka ndryshuar, çështje që është premtuar gjatë fushatës zgjedhore, dhe kjo nuk ka ndryshuar.
- Çështja e kontejnerëve nëpër hapësira të ndryshme të qytetit po i japin qytetit një pamje të shëmtuar jashtëzakonisht. A është ndërmarrë ndonjë hap rreth ndërmarrjes "Pastrimi", që mos të na përsëritet ajo gjendje që ishte më parë?
- Rruga "Qëndresa" në Mat është e pakalueshme, është kërkesë e asaj lagje që të bëhet një intervenim sa më i shpejt.
- Ansambli i valleve "Kosova", një ansambël i vjetër, ka një kërkesë për sallë për ushtrime dhe për performim. Ata kanë probleme me këto sallat aktuale, nuk i lejojnë as në "Pallatin e Rinisë", as te ansambli "Shota", dhe kanë probleme të ndryshme.
- Për ditën e çlirimit kur është bërë ndarja e mirënjohjeve për ata të cilët i kanë liruar shtëpitë e tyre për shkolla, mendoj se ndarja e mirënjohjeve ka qenë në mënyrë selektive për shkak se një numër prej atyre të cilët i kanë lëshuar shtëpitë nuk kanë qenë të ftuar atë ditë.
- Në një diskutim publik mbi Strategjinë e energjisë 2022-2031, që është mbajtur në këtë sallë të Kuvendit dhe nuk ka qenë asnjë përfaqësues i pranishëm, gjë që nuk ka ndodhur nëpër qytet tjera.

Lidhur me pyetjet dhe shqetësimet e ngritura nga z. Sveçla, sqarime shtesë dhanë Përparim Rama, kryetar, Donjeta Sahatçiu, nënkryetare dhe Ajet Brajšhori (në cilësinë e kryesuesit të Kuvendit).

Arbër Vokrri, për Kryetarin e Komunës:

- Kërkoj të dijë arsyen e ndërrimit të adresave të disa lagjeve të qytetit. Me rastin e ndërrimit të adresave kishte me qenë e rrugës që ndoshta ndonjëherë me u këshillua edhe me banorët e këtyre lagjeve rreth vendbanimit të tyre.
- Në lagjen "Dardania" te "Saranda Turs", janë duke u zhvilluar punimet, është gërmuar rreth e rrotull, afër banesave të banuara, është hequr asfalti dhe betoni. Jemi të interesuar me e ditur se çka është duke u punuar dhe kush është duke e bërë.
- Disa qytetarë kanë shpreh shqetësimin e tyre rreth pastrimit të pishinës së Gërmisë, dhe kërkojnë të dinë se a është bërë pastrimi apo jo para se ajo të lëshohet në përdorim.

Lidhur me pyetjet dhe shqetësimet e ngritura nga z. Vokrri, sqarime shtesë dhanë Përparim Rama, kryetar, dhe Pëllumb Bajqinovci (në cilësinë e aksionarit në ndërmarrjen "Sport Marketing").

Arianit Beqiri, për kryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Sportit:

- Rruga "Bajram Bahtiri", prej Bunarit të Hajratit e deri te ish- ushtria në fshatin Llukar, është e vjetruar dhe pa trotuar, që paraqet një rrezik të madh për udhëtarët.
- A është ndërmarrë ndonjë iniciativë për organizimin e 100 vjetorit të klubit "Prishtina"?
Për veç saj, pra do të ishte mirë që Komuna e Prishtinës të bashkëngjitet për një organizim të tillë, sepse mendoj që përveç që është simbol i Prishtinës, është mbase edhe i Kosovës.
- Ambienti dhe mbeturinat janë shqetësim shumë i madh për të gjithë qytetarët e Prishtinës dhe është më se e nevojshme që të sillen ndonjë ligj apo rregullore që i ndalon qeset, të paktën me i sensibilizuar qytetarët, që në markete kur të shkojnë të marrin me vete torbën për të mos shpenzuar shumë në qese.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Beqiri, sqarime shtesë dha Përparim Rama, kryetar.

Besart Krasniqi, për drejtorin e Drejtorisë së Sportit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Është shqetësim i qytetarëve për gjendjen e shtigjeve të vrapimit në Taukbahçe dhe në parkun e Arbërisë. Ata kërkojnë që të bëhet rregullimi i këtyre shtigjeve, pasi që veç janë të dëmtuara. Po ashtu, kërkoj që pajisjet e fitnesit në këto vende, duke e përfshirë edhe parkun "Gërmia" të jenë të qëndrueshme, funksionale dhe të përshtatën për vizitorët.
- A ka ndonjë plan për rregullimin e varrezave në fshatin Shashkovc, me qenë se ato janë të dëmtuara.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Krasniqi, sqarime shtesë dha Përparim Rama, kryetar.

Rashit Gashi, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, drejtorin e Drejtorisë së Pronës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Janë dy rrugica në dy lagje të fshatin Mramor, njëra është "Muharrem Ramizi" e tjetra është "Halit Gashi", të cilat janë në gjendje jo të mirë dhe është më se i nevojshëm rregullimi i tyre.
- Po ashtu, në këtë fshat në vitin 2004 është bërë një devijimi i rrugës, në gjatësi prej 50 m., në lagjen "Veqeraj", ku për shkak të shpronësimit ka mbetur ashtu si është dhe është rrezik me kaluar atypari.
- Gjithashtu, po në këtë rrugë për shkak të shpronësimit, tani janë vendosur shtyllat në rrugë dhe nuk e kanë lejuar asfaltimin e saj pjese, kështu që projekti ka ngecë, është ndërprerë. Nga Drejtoria e Investimeve kapitale kërkojmë që të bëhet shpronësimi, se në këtë gjendje nuk mundemi me vazhduar tutje.
- Një kërkesë në lidhje me varrezat e fshatit Mramor, në dy lokacionet e ndryshme, është shqetësim serioz i banorëve, pasi që varrezat janë të stërmbushura me varre,

prandaj kisha pasur dëshirë që me e marrë në konsideratë këtë kërkesë për të gjetur një lokacion të përshtatshëm.

- Ka disa rrugë në qytet dhe fshatra, të cilat nuk janë dezinfektuar, po ashtu edhe disa lagje të qytetit, një pjesë e lagjen "Pejton", rruga "Jonuz Zejnullahu", rruga "Harmonia" rruga "Johan Han", rruga "Naum Veqilharxhi".
- Shqetësim për banorët e fshatit Mramor është edhe transporti i udhëtarëve, e që prej vitit 2010 ka kalua në një operator, i cili është i trafikut urban, por ajo çka është shqetësuese është se tani kur nxënësit kanë pushim në kohën e verës, operatori i ka reduktua linjat e transportit për shkak të rritjes enorme të çmimit të karburantit. Gjithashtu, mujoret për nxënës dhe studentë që i lëshon ky operator, janë të shtrenjta në krahasim me ato të Trafikut Urban. Kërkoj që këto të merren parasysh.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Gashi, sqarime shtesë dhanë Doruntinë Maloku, Drejtore, dhe Përparim Rama, kryetar.

Dasmor Durmishi, për kryetarin e Komunës:

- Kërkoj që kontejnerët e ndërmarrjes "Pastrimi" të zëvendësohen me kontejner më adekuat, pasi që kontejnerët aktual janë jo të përshtatshëm edhe për punëtorët e kësaj ndërmarrje.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Durmishi, sqarime shtesë dha Përparim Rama, kryetar.

Ermal Osmani tha se me rastin e humbjes së jetës së një të riu 30 vjeçar në komunën tonë, për shkak të erërave të forta që kanë fryrë atë ditë, kisha propozuar që nëse ndihet e arsyeshme, në mbledhjen e radhës ta mbajmë një minutë heshtje.

Pika e katërbëdhjetë Të ndryshme

Gëzim Sveçla, tha se shqetësimet e mia kanë të bëjnë me ndërmarrjet publike komunale. Faktikisht në Planin e punës së Kuvendit, parashihet që me pasur raportime për këto ndërmarrje gjë, që nuk ka ndodhur deri më tani. Disa ndryshime të cilat janë bërë me emërime të bordeve të përkohshme, të cilat për hir të korrektësisë, duhet me treguar që i kemi dërgua për shqyrtim në MAPL, për shkak ka shkelje të ligjshmërisë, megjithatë ju mbetet organeve kompetente të vendosin për atë çështje.

Çështja tjetër e që vazhdon të jetë brengë e qytetarëve, është rregullorja e ndërmarrjes "Prishtina Parking". Kur do të hartohet kjo rregullore, se kjo ndërmarrje po vazhdon të zgjerohet nëpër lagje të ndryshme të qytetit, e që është një kontraditë e deklaratave në mes të parit të qytetit dhe menaxhmentit të ndërmarrje, që na shtyn në hamendësime se a ka kryetari kontroll në "Prishtina Parking", apo si qëndron problemi?

Lidhur me çështjet e ngritura nga z. Sveçla, sqarime shtesë dha Donjeta Sahatçiu, nënkryetare.

Rashit Gashi, ngriti shqetësim rreh gjendjes së pyjeve në fshatin Butovc, duke pyetur se cili është ai operator ekonomik aq i privilegjuar, çfarë autoriteti ka ai, se ai është duke bërë prerjen ilegale të pyjeve. Është seanca e tretë që po e nge këtë shqetësim, se prerja ilegale e druve të llojit ahu në atë pjesë, nuk është duke u ndalur. Ajo pjesë është në degradim e sipër, është duke u bërë një prerje masive e druve dhe nuk di pse nuk po reagon në këtë rast Drejtoria e Inspeksionit.

Feim Osmani, ngriti shqetësim rreth furnizimit me rrymë elektrike në fshatrat Besi dhe Barilevë, i cili tha se këta banorë janë të privuar nga tensioni normal i rrymës për funksionim të amvisërisë edhe të gjitha çështjet që lidhen me tensionin e rrymës. Ai kërkoi nga Komuna që të bëjë ndikim te KEDS-i për gjetjen e mundësisë së normalizimit të rrymës elektrike.

Po ashtu, në këto fshatra prezent janë edhe reduktimet e ujit, si dhe mungesa e shtypjes së tij.

Ai kërkoi nga ekzekutivi që të bënë ndikim te ndërmarrja "Ujësjiellësi" për normalizimin e rrjetit të ujësjiellësit.

Lidhur me çështjet e ngritura nga z. Osmani, sqarime shtesë dha Donjeta Sahatçiu, nënkryetare.

Ermal Osmani, tha se unë jam i involvuar drejtpërdrejt edhe me KEDS-in edhe me "Ujësjiellësin", kjo nuk është çështje e cila ka filluar tani, ka shumë vite, ndoshta diku prej vitit 2016 jemi në përpjekje e sipër me bërë zgjidhje, sepse është fjala për fshatin Besi, konkretisht për lagjen time, dhe gjithsesi kam materiale, kam informata të cilat do t'i përcjell dhe do të koordinohemi pa tjetër për masat ose veprimet që do t'i marrim në vijim.

Arbnora Berisha kërkoi nga të gjithë drejtorët e drejtorive komunale, që mundësisht t'i kthejnë përgjigjet për pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit, sepse gjithnjë po bëjmë kërkesa dhe nuk po na kthehen përgjigjet.

Arianit Beqiri tha se ku jemi me procesin e digjitalizimit të Komunës, procesi tani veç po ec përpara, siç është nxjerrja e certifikatave dhe dokumenteve të tjera, por jam i interesuar me ditur se a kemi kapacitete dhe a presim që deri në fund të këtij mandati të kryhen disa procese të digjitalizimit, qofshin ato dokument me i nxjerrë qytetarët që nuk kanë nevojë të presin në radhë.

Lidhur me çështjet e ngritura nga z. Beqiri, sqarime shtesë dha Donjeta Sahatçiu, nënkryetare.

Mbledhja përfundoi në orën 18:45.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina

Faqe23nga23